**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
***Qeveria - Vlada - Government***

Nr. 01/149
Datë: 19.09.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 shtator 2013, mori:

# V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të Punës në Ministrinë e Diasporës.

2. Obligohet Ministria e Diasporës dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:
- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

# Republika e Kosovës

**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 02/149
Datë: 19.09.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 shtator 2013, mori:

## V E N D I M

1. Aprovohet Udhëzimi Administrativ për Kompensimin e punës jashtë orarit dhe pjesëmarrjen në seanca gjyqësore të ekspertëve mjeko-ligjorë.

2. Obligohet Ministria e Drejtësisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Udhëzimit nga pika 1. e këtij vendimi.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:
- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
***Qeveria - Vlada - Government***

---

Nr. 03/149
Datë: 19.09.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 shtator 2013, mori:

## V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja për Pagesat e personelit trajnues dhe mësimdhënës si dhe ekspertëve të fushave funksionale.

2. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:
- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 04/149
Datë: 19.09.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 shtator 2013, mori:

## V E N D I M

1. Themelohet Këshilli Ndërministror për Ujërat, si trup koordinues dhe vendimmarrës që shqyrton çështjet sistemore të administrimit me ujëra, harmonizimin e nevojave dhe interesave të ndryshme, si dhe propozon masat për zhvillimin, shfrytëzimin dhe mbrojtjen e resurseve dhe sistemit ujor të Kosovës në këtë përbërje:

    1.1. Bujar Bukoshi, Zëvendëskryeministër, - Udhëheqës;
    1.2. Ministri i Zhvillimit Ekonomik, - anëtarë;
    1.3. Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor - anëtarë;
    1.4. Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal - anëtarë;
    1.5. Ministri i Integrimeve Evropiane - Anëtarë;

2. Këshilli Ndërministror për Ujëra jep mendime dhe rekomandime për:

    2.1. propozim ligjet dhe aktet tjera nënligjore që kanë të bëjnë me rregullimin e çështjeve nga fusha e ujërave në përgjithësi;
    2.2. zbatimin e ligjeve dhe akteve nënligjore që kanë të bëjnë me menaxhimin e ujërave;
    2.3. hartimin dhe aprovimin e Strategjisë Shtetërore për ujëra;
    2.4. zhvillimin e politikave nga fusha e ujërave;
    2.5. zgjedhjen e politikave financiare nga fusha e ujërave.

3. Këshilli Ndërministror për Ujëra kryen edhe detyrat tjera të përcaktuara me Ligjin nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës.

4. Anëtarë të Këshillit pa të drejtë vote janë edhe Përfaqësuesi i Zyrës Zvicerane për Bashkëpunim (si koordinator të sektorit të ujërave në komunitetin e donatorëve) dhe përfaqësues (me rotacion) të donatorëve aktiv në sektorin e ujërave.

5. Këshilli Ndërministror për Ujërat do të ketë Sekretariatin e tij, i cili do të ndihmojë në kryerjen e punëve dhe obligimeve të Këshillit. Sekretariati do të funksionojë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit dhe do të përkrahet nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim, për katër vite (deri në shtator 2017).

6. Sekretariati do të kryejë detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me Rregulloren e punës të miratuar nga Qeveria.

7. Mjetet për shpenzimet e punës së këshillit ndërministror të ujërave sigurohen nga Buxheti i Republikës së Kosovës.

8. Këshilli ndërministror i ujërave përgatitë raporte vjetore të cilat i raporton para Qeverisë dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës.

9. Obligohen të gjitha Ministritë e linjës ta ndihmojnë dhe përkrahin Këshillin për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësive.

10. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi i Qeverisë nr. 06/91 (12.09.2012) dhe shuhet Task Forca e Ujërave në kuadër të Zyrës së Kryeministrit e krijuar sipas Memorandumit të Mirëkuptimit me datë 07 tetor 2008, mes Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë Zvicerane.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:
- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 05/149
Datë: 19.09.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 shtator 2013, mori:

**V E N D I M**
**Për ndryshimin dhe plotësimin e Programit Legjislativ të vitit 2013 të Qeverisë së Republikës së Kosovës**

1. Në Programin Legjislativ të vitit 2013 të Qeverisë së Republikës së Kosovës të përfshihen edhe këto Projektligje:

   1.1. Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes për Statusin e anëtarëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe Forcës së Sigurisë së Republikës së Kosovës gjatë qëndrimit të tyre të përkohshëm në territorin e shteteve respektive (MFSK);
   1.2. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-127 për Regjistrimin e Bujqësisë (MBPZHR).

2. Obligohet Zyra Ligjore në Zyrën e Kryeministrit për zbatimin e këtij Vendimi.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:
- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 06/149
Datë: 19.09.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 shtator 2013, mori:

# V E N D I M

1. Organizatat buxhetore që kanë përgatitur projekte për aplikim në kuadër të skemës së kredive të buta të financuara sipas marrëveshjes për bashkëpunim financiar në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Austrisë duhet ti përfshijnë projektet e tyre në kuadër të buxhetit për vitin 2014.

2. Ministria e Financave do ti përcaktoj kufijtë buxhetor për secilën organizatë buxhetore në procesin e rregullt buxhetor në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë dhe do të përcaktojë mënyrën e financimit të tyre.

3. Parakusht për dhënien e pëlqimit dhe fillimin e negocimit të marrëveshjeve financiare për organizatat buxhetore nga Ministria e Financave me bankat Austriake për projektet që kanë filluar të studiohen është përfshirja e tyre në kuadër të kufijve buxhetorë për vitin 2014.

4. Rregullat e përcaktuara me këtë vendim vlejnë edhe për zbatimin e vendimit të Qeverisë nr. 05/119 të datës 13 mars 2013.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:
- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 07/149
Datë: 19.09.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 3 të Ligjit për Normën e Tatimit të Akcizës nr. 03/L-220 i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 03/L-112, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 shtator 2013, mori:

## V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Financave për ndryshimin e normës së akcizës në duhan të Aneksit A të Ligjit nr. 03/L-220 për Normën e Tatimit të Akcizës në Kosovë, edhe atë:

    1.1 Ngritët norma e akcizës në duhan me numër tarifor 240220 dhe 2403, nga 27 euro për njësi në 30 euro për njësi, duke filluar nga data 1 tetor, 2013.

    1.2 Ngritët norma e akcizës në duhan me numër tarifor 240220 dhe 2403, nga 30 euro për njësi në 32 euro për njësi, duke filluar nga data 1 janar, 2014.

2 I rekomandohet Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës që të konsultohet me Komisionin për Buxhet dhe Financa të Kuvendit të Republikës së Kosovës konform nenit 3 të Ligjit për Normën e Tatimit të Akcizës nr. 03/L-220 i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 03/L-112 për Tatimin e Normës së Akcizës në Kosovë.

3 Obligohet Dogana e Kosovës që në vështrim të nenit 9 paragrafi 1 dhe 2 të Kodit Doganor dhe Akcizës nr. 03/L-109 dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

4 Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe zbatohet në përputhje me pikën 1.1 dhe 1.2 të këtij vendimi, pas konsultimeve me Komisionin për Buxhet dhe Financa të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

5 Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:
- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 08/149
Datë: 19.09.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 shtator 2013, mori:

**V E N D I M**
**Për shfuqizimin e Vendimeve të Qeverisë Nr. 08/117 dhe Nr. 10/117 të datës 27 shkurt 2013**

1. Shfuqizohen Vendimet e Qeverisë nr. 08/117 dhe nr. 10/117 të datës 27 shkurt 2013.

2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:
- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 09/149
Datë: 19.09.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit nr. 04/l-042 për prokurimin publik në Republikën e Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 shtator 2013, mori:

## V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës për kryesues dhe anëtarë në Organin Shqyrtues të Prokurimit i propozon Kuvendit të Republikës së Kosovës, këta kandidatë:

   1.1. Hysni Hoxha, Kryesues
   1.2. Ekrem Salihu, anëtarë;
   1.3. Tefik Sylejmani, anëtarë dhe
   1.4. Vjollca Kurtishaj, anëtare;

2. Obligohet Sekretar i Zyrës së Kryeministrit që vendimin së bashku me biografitë e të propozuarve t'ia procedojë për shqyrtim dhe emërim Kuvendit të Republikës së Kosovës.

3. Vendimi hynë ne fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:
- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 10/149
Datë: 19.09.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-111, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 shtator 2013, mori:

**V E N D I M**

1. Qeveria e Republikës së Kosovës për drejtor në bordin e Ndërmarrjes Publike Korporata Energjetike e Kosovës Sh. A. emëron këta kandidatë:

    1.1. Berat Rukiqi, Kryesues;
    1.2. Haki Mjeku, anëtarë;
    1.3. Enver Muli, anëtarë;
    1.4. Ranko Makic, anëtarë;
    1.5. Burim Leci, anëtarë dhe
    1.6. Pranvera Dobruna-Kryeziu, anëtare.

2. Të emëruarit nga pika 1. e këtij vendimi kryejnë detyra dhe përgjegjësi në pajtim me Ligjin nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-111 dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

3. Mandati i të emëruarve nga pika 1. e këtij vendimi zgjatë tre (3) vite.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:
- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 11/149
Datë: 19.09.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 shtator 2013, mori:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Rregullorja për arsimin e lartë në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike.

2. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:
- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë